

## ■ HULUMTIM- TREGU I Z I VIAGRËS (2)

## VIAGRA MUND TË GJENDET KUDO

Mjekët thonë se Viagra bën pjesë në grupin e ilaçeve që jepen me rekomandim të mjekut. Por deri në fillim të muajit nëntor të vitit 2008, njëjtë si të gjitha ilaçet, ky lloj medikamenti mund të blihet pa problem në çdo farmaci të Maqedonisë. Viagra nuk bën pjesë në listën e ilaçeve që rëndon mbi Fondin për Sigurime Shëndetësore. Ajo kushton 2 196 ose 2 618, 56 denarë varësisht prej dozës, 50-të ose 100 miligram

## GËZIM SULEJMANI

Hulumtimi rezultoi me faktet se në Maqedoni mund të gjenden tre lloje të viagrave: me recetë, që janë të dalleshme për banderolën e Maqedonisë dhe shiten në mënyrë legale, pastaj viagra origjinale të importuara nëpërmjet rrugëve ilegale në vend dhe viagra të falsifikuara, të cilat në medicinë njihen me emrin "placebo pilula". Përveç tregëtisë, edhe shitja e viagrave bëhet para syve të institucioneve.

Përveç nëpër barnatore, viagra shitet edhe në shitoret erotike, në disa qoshqe edhe nëpërmjet internetit. "Pilulat magjike" qytetarët mund t'i sigurojnë pa asnjë problem edhe pse shteti zyrtarisht me ligje ka vendosur ta sanksionojë dhënien e këtij medikamenti pa kontroll mjekësor adekuat apo pa recetë. Vetëm para një muaji farmacistë kanë marrë urdhër që të mos shesin ilaçe pa recetë, përveç analginave, vitaminave dhe paracetamolëve. Por, hulumtimi tregoi se pjesa dërmuese e barnatoreve nuk e respektojnë këtë ndalesë. Nga tre prej tyre që u zgjodhën rastësisht nga gazetari, asnjëra prej tyre nuk mundi t'i qëndrojë prapa kërkesës për recetë. Vetëm një këmbëngulësi e vogël e zëvendëson recetën e kërkuar.

## Masat kundër falsifikimit

"Nuk do të tolerojmë asnjë farmaci, që do të shesë pa recetë antibiotikë, ilaçe kundër infeksioneve që shkakto-

hen nga viruset, ilaçe hormonale, apo preparate të tjera. Dënimet për farmacistë që do të shesin ilaçe pa recetë janë shumë të larta, nga 25 deri në 50-të mijë euro", thotë drejtori i Byrosë së Ilaçeve, Ilčo Zahariev. Ai nuk ka informacion nëse inspektionet, kanë marrë ndonjë aksion për të verifikuar shitjen e viagrave pa recetë. Sipas specialistëve, efekti i viagrës së falsifikuar është gjysmak dhe përdorimi i saj mund të sjellë edhe pasoja fatale. Zahariev thotë se falsifikatët e ilaçit Viagra, vijnë nga shtetet e zhvilluar, ndërkohë që në hapësirat e gadishullit të Ballkanit, janë zënë sasi të mëdha të Viagrës së falsifikuar. "Kishte edhe dy raste kur ky lloj falsifikati donte të futej në Maqedoni, njëri vinte nga Kosova, ndërsa tjetri me linjë ajrore dhe u gjet në aeroportin 'Aleksandri i Madh', sqaron Zahariev. Ai njoftoi se, në bazë të analizave të bëra në laboratorët e Byrosë, preparati ka pasur komponentë aktive, jo 100 miligram sa ka qenë deklaruar, por 60 miligram, ose 60 për qind të komponentës, ndërsa, pamja e tabletës, ngjyra dhe logoja e kompanisë janë falsifikuar në mënyrë shumë të suksesshme, ndaj dhe qytetarët e thjeshtë nuk mund ta dallojnë se bëhet fjalë për falsifikat.

"Nëse një ilaç i tillë nuk zbulohet dhe gjendet në qarkullim në tregun e zi, nuk mund ta arrijë veprimin e kërkuar farmakologjik dhe e dyta meqë është prodhuar në lokacion të panjohur, nuk dihet se çfarë gjërash të tjera përmban,



pasi për t'i dhënë formën tabletës duhet t'i shtohet diçka tjetër. Efekti i viagrave të falsifikuara është 50-të për qind më i ulët dhe mendohet të ketë efekt dëshpërues edhe për femrën, pasi këtu kemi efekt gjysmak dhe rreziku mund të jetë tepër i lartë edhe për shëndetin e pacientit", thotë Zahariev.

## Viagra pa recetë

Mjekët thonë se Viagra bën pjesë në grupin e ilaçeve që jepen me rekomandim të mjekut. Por deri në fillim të muajit nëntor të vitit 2008, njëjtë si të gjitha ilaçet, ky lloj medikamenti mund të blihet pa problem në çdo farmaci të Maqedonisë. Nga një nëntori, Byroja e Ilaçeve, ndërmori masa rigorozë për ndalimin e shitjes së ilaçeve pa recetë dhe zbatimin e Ligjit të Ilaçeve. Në ditët e para të vendosjes së masave rigorozë farmacistët i përmbaheshin ligjit. Viagra nuk bën pjesë në listën e ilaçeve që rëndon mbi Fondin për Sigurime Shëndetësore. Ajo kush-

ton 2 196 ose 2 618, 56 denarë varësisht prej dozës, 50-të ose 100 miligram.

Por, klientët me shumë preferojnë ta blejnë viagrën "në të zeze", pa kontrollë mjeksore dhe recetë. Millka Petrushevska, farmacistë në "Replek" thotë se persona të moshës së thyer shkojnë dhe kërkojnë për të blerë Viagra pa recetë.

"Deri më tani persona më të moshuar vinin dhe kërkonin të blinin viagra. Tani që ka hyrë në fuqi ligji dhe nuk japim më viagra pa recetë, por gjatë asaj kohe përgjithësisht persona më të moshuar vinin për të blerë viagra", thotë Petrushevska. Ajo sqaron se edhe gjatë muajit nëntor, mjaft persona kanë shkuar për të blerë viagra pa recetë të mjekut.

"Po, po përsëri vijnë dhe kërkojnë që të blejnë viagra pa recetë, por ne më nuk japim ilaçe pa recetë", thotë Petrushevska. (vazhdon)

(Hulumtimi është realizuar me mbështetjen e SCOOP-it dhe Shoqatës Daneze për Gazetari Hulumtuese)

## ÇËSHITJA E BIZNESMENIT NGA MAQEDONIA

## Berisha e dinte për zhdukjen e Hoxhës?



Gjenerali Agim Shehu deklaroi të martën para Gjykatës se ish-presidenti dhe kryeministër aktual i Shqipërisë, Sali Berisha, kishte qenë në dijeni për zhdukjen e biznesmenit shqiptaro-maqedonas, Remzi Hoxha, më 1995. Agim Shehu, asokohe në postin e ish-drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dëshmoi të martën në seancën gjyqësore që po zhvillohet në Gjykatën e Krimeve të Rënda në Tiranë, për ngjarjen e ndodhur rreth

14 vjet më parë. Për ngjarjen akuzohen tre ish-SHIK'as. Agim Shehu, ish-drejtori Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe njëkohësisht, ish-zëvendësministër i Brendshëm ishte të martën dëshmitar në gjykimin për rrëmbimin, e pastaj edhe për vrasjen e biznesmenit shqiptaro-maqedonas, Remzi Hoxha. Për krimin e kryer rreth 14 vjet më parë në bankën e të akuzuarve janë ulur edhe tre ish-SHIK'asit, Arben Sefgjini, Ilir Kumbaro dhe

Avni Koldashi.

"Për ngjarjen e kam vënë në dijeni presidentin e Republikës në atë kohë, Sali Berishën, dhe kryetarin e Kuvendit, Pjetër Arbnori", deklaroi të martën para trupit gjykues gjenerali Agim Shehu. Ndërkaq, mbi bazën e denoncimit të bërë nga familjarët që lidhje me largimin nga shtëpia të Remzi Hoxhës, Shehu dëshmoi se, sektori i Policisë Kriminale të Komisarariatit Nr. 3 të Tiranës i kishte kryer të gjitha procedimet e nevojshme penale dhe se kishte filluar edhe çështja penale nga ana e Prokurorisë së Tiranës.

"Nga hetimi i çështjes nuk rezultoi të jenë zbuluar autorët e kësaj vepre, e as nuk është bërë i mundur zbulimi i autorit. Çështja iu kthye sërish Prokurorisë së Tiranës me kërkesë të saj, ndërkaq Policia Kriminale ka hapur një dosje për zbulimin e autorëve të kësaj vepre", thuhej në letërën që Agim Shehu ia kishte drejtuar presidentit të atëhershëm dhe kryeministrit aktual të Shqipërisë, Sali Berishës. Më tej, në letër Shehu informonte edhe për atë se targat e veturës me të cilën u

rrembyer Remzi Hoxha, më 21 tetor të 1995,

nuk ishin hedhur fare në qarkullim nga ana e policisë së shtetit. Ndërkohë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit shqiptar pohoi të ketë pasur shumë takime edhe me prokurorin e përgjithshëm të asaj kohe, megjithëse sqaroi se nuk mbante në mend të kishte biseduar edhe për rastin e Remzi Hoxhës. Gjenerali Shehu u shfaq në gjykatë pas kërkesës së prokurorit të çështjes, Xhevat Hana, në seancën paraprake, sipas së cilës dëshmitari duhej të paraqitej me forcë po që se nuk pranonte të vinte me vetëdëshirë. Në këtë proces pritet të dëshmojnë rreth 100 dëshmitarë, e në mesin e tyre dhe disa ish-funksionarë të lartë të policisë ose SHIK'ut në kohën kur ndodhi kjo ngjarje. Përveç zhdukjes së biznesmenit shqiptaro-maqedonas, mbi supet e tre ish-shikasve, Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Ilir Kumbaro, rëndojnë dhe akuzat për rrëmbimin dhe torturimin e Ziso Kristopullit dhe Avdyl Loshajt. Remzi Hoxha u mor peng më 21 tetor 1995, dhe që prej asaj dite nuk dihet më asgjë për fatin e tij. Prokuroria akuzon tre ish-punonjësit e SHIK'ut, se e kanë torturuar dhe pastaj edhe e kanë zhdukur atë. (BalkanWeb)

## ANALIZË E INSTITUTIT PËR HULUMTIMIN DHE KRIJIMIN E POLITIKAVE Duhet të funksionojë demokracia konsensuale

Në Maqedoni duhet të funksionojë demokracia konsensuale pasi vetëm në këtë mënyrë rrafshohen dallimet politike dhe etnike, gjë që krijon stabilitet politik. Kështu thuhet në analizën e Institutit për hulumtimin dhe krijimin e politikave. Hartuesi i saj, Dane Talevski thotë se duhet të bëhen përpjekje më të mëdha që mekanizmat e demokracisë konsensuale të funksionojnë në institucionet e sistemit politik dhe të cilat garantojnë me Kushtetutë.

Në studimin me temën "Dialogu politik në Maqedoni pas Marrëveshjes së Ohrit" të përgaditur nga Instituti për hulumtimin dhe krijimin e politikave theksohet se Maqedonia ka nevojë për zbatimin e demokracisë konsensuale. Në analizën e përgaditur nga Dane Talevski, ekspert i çështjeve politike theksohet se për t'u zhvilluar demokracia konsensuale në Maqedoni, është e nevojshme që të kuptohet se shumica parlamentare nuk nënkupton fuqi dhe dominim, por përgjegjësi dhe përkushtim.

"Hapësira politike në Maqedonia ka dallime dydimensionale, politike dhe etnike dhe është e nevojshme që ato te ato te refelektohen në sistemin politik dhe institucionet e shtetit t'i menaxhojnë dallimet që te këto stabilitet. Maqedonia fitoi një sistem të tillë me zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit por ai nuk u zbatua në teresi pasi çështjet politike shpesh zgjidhen në takimet e lidereve të partive politike e jo në Kuvend apo institucionet tjera të shtetit, tha Talaveski", tha analisti politik, Dane Ilievski.

Sipas tij nuk ka dialog politik pasi nuk funksionojnë mekanizmat e demokracisë konsensuale.

"Pershebull Komiteti për marrëdhënie ndëretnike nuk mban seanca dhe është transferuar në një organ joformal, nuk ka bashkëpunim të mirë midis shumicës parlamentare dhe opozitës dhe paraiten tensione politike", tha Ilievski. Ndërsa, profesori i Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë (UEJL), Zemri Elezi deklaroi se funksionimi i demokracisë konsensuale do ta shndërojë Maqedoninë në shtet shumëetnik.

"Në shtetet shumëetnike nuk mund t'i evitohet demokracisë konsensuale. Edhe pse kemi disa mekanizma që rezultojnë nga Marrëveshja e Ohrit siç parimi i Badenterit apo votimit të dyfishtë, decentralizimi i pushtetit por ato janë minorë për tu arritur demokracia konsensuale, e cila shumë ngadalë zhvillohet dhe zbatohet në veprimtarinë e institucioneve të shtetit", tha Elezi.

Studimi nënvizon se shumica praktikohet në kundërshtim me ndarjet që ekzistojnë në skenën politike e cila është e ndarë edhe në vija etnike, andaj ajo duhet t'i përshtatet realitetit të ri. (Radio Evropa e Lirë)